

Kulloshtra për viça të shëndetshëm

Përgatitur nga Franz Riegler, konsulent i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk.

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka



Foto: www.agrarheute.com

Kulloshtra: Një furnizim i mjaftueshëm me kullostër është thelbësor për shëndetin dhe zhvillimin e viçit të porsalindur. I porsalinduri duhet të ketë konsumuar të paktën tre litra kullostër jo më vonë se dy orë pas lindjes.

Rreth një e treta e të gjithë viçave në Europë kanë një furnizim të pamjaftueshëm të imunoglobulinave. I pamjaftueshëm do të thotë: niveli i përgjithshëm i proteinave në serum nën 52 g / l ose nivelet e imunoglobulinës serum nën 10 g / l. Rezultatet e një studimi në të cilin pesha specifike e kulloshtrës u përcaktua duke përdorur një "koloastro-metër" çuan në deklaratat e mëposhtme, ndër të tjera: Matja me koloastro-metër lejon vetëm nxjerrjen e konkluzioneve të pjesshme në lidhje me përmbajtjen imune, meqënëse pesha specifike përcakton vetëm përmbajtjen e proteinave të kulloshtrës dhe nuk riprodhon atë të imunoglobulinave.

Kulloshtra e lopëve me një maksimum prej dy viçash ka një peshë specifike më të ulët se ajo e lopëve me disa laktacione. Këto ndryshime vijnë kryesisht nga përqëndrimi i ndryshëm i përbërësve të qumështit dhe jo nga përqëndrimi i ndryshëm i imunoglobulinës.

Cilësia e kulloshtrës nuk ndikohet nga periudha e thatë. Nëse qumështi "rrjedh" nga thithka gjatë periudhës së thatë, cilësia e kulloshtrës është dukshëm më e keqe. Viskoiziteti dhe ngjyra e kulloshtrës nuk lejojnë që të nxirret ndonjë konkluzion në lidhje me cilësinë e tij. Sezoni ka ndikimin më të madh në kulloshtrës: pesha specifike ose përmbajtja e proteinave është në verë më e ulët. Niveli i imunoglobulinës G mbetet i paprekur. Për më tepër, u zbulua edhe një herë se njerëzit ushtrojnë ndikimin më të madh në transmetimin e imunoglobulinës tek viçi: Për shkak të përmbajtjes më të lartë të imunoglobulinës te lopët me prodhim të lartë, vihet re efekti i hollimit, ku kulloshtra ulet me 3.7% në orë. Meqënëse viçi mund të marrë vetëm një sasi të kufizuar qumështi pas lindjes, kjo varet nga përqëndrimi më i lartë i mundshëm i antitropave.

Higjiena në prodhimin e kulloshtrës ndikon drejtpërdrejtë në përmbajtjen e mikrobeve dhe zhvillimin e diarresë tek viçat e porsalindur. Gjithashtu është provuar një efekt negativ i konsumimit të sasive më të mëdha kulloshtrës - tre litra dhe më shumë - si dhe administrimi i kolostrumit përmes një tubi në rumen ("zhytje") mbi shpejtësinë e zbrazjes së abomasumit dhe transferimit të imunoglobulinës. U kërkua të kryhej në stallë një test i shpejtë përmes gjakut për të përcaktuar e furnizimit me imunoglobulinë të viçit.

Një studim tjetër vendosi në vëmendje praktikat joadekuate të të ushqyerit. Arsyeja për këtë është një sondazh i 102 fermave në Ishujt Britanikë, sipas të cilit më pak se 30% e viçave në një moshë prej tre javësh arritën të kishin më shumë se 700 g shtim të peshës ditore. Në këtë kontekst, u tregua se në një fermë të specializuar në rritjen e viçit, e cila strehonte viça me origjinë të ndryshme, u sëmurën kryesisht viçat me një peshë të ulët trupore. Gjithashtu, u bë një zbulim i mëtejshëm: prognoza për një kurim të plotë të "gripi të viçit" ose të një bronkopneumonie enzootike ishte edhe më i pafavorshëm, sa më herët një viç u sëmuri pasi ishte strehua.